



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 320

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. KRISTIAN LUIGJ SHKRELI, KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE, I PROPOZUAR
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR BASHKINË VAU I DEJËS**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Kristian Luigj Shkreli, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Vau i Dejës.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Data 12.4.2023 Nr: 320
Ora:12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Kristian Luigj Shkreli, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Vau i Dejës"

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Kristian Luigj Shkreli, është regjistruar si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Vau i Dejës.

Për këtë kandidat, në datën 30.3.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili, është regjistruar me nr. unik SHK-PS-10052. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë, nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Kristian Luigj Shkreli, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij, Mbiemri i mëparshëm: Kola.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju, masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, nga shteti Italian në vitin 2007 për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes “A keni jetuar ndonjë herë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. Në shtetin Italian nga viti 2005 deri në vitin 2007.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve, si më sipër, në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja.

Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime. Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin

nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Kristian Luigj Shkreli, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Vau i Dejës dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI